



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.1831/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit KUR “Mitrovica” J.S.C, Sh.A, me numër fiskal 600338033, kundër debitorit A. Q.,– Ordinanca Stomatologjike, me seli në V., rr. “...”, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, KPPP.nr.1505/23, i datës 01.08.2024, me datë 27.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit KUR “Mitrovica” J.S.C, Sh.A, me numër fiskal 600338033, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, KPPP.nr.1505/23, i datës 01.08.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1505/23, të datës 01.08.2024, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit A. Q., – Ordinanca Stomatologjike, me seli në V., i paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.106/23, i lejuar me datë 05.04.2023 nga Përmbartuesi Privat Fazli Gjonbalaj, dhe të njejtin urdhër e ka shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit, dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar ose lënda të kthehet në rigjykim.

Debitori në përgjigje në ankesën e kreditorit, ka theksuar se aktvendimi i atakuar me ankesë është i drejtë dhe i mbështetur në dispozita ligjore, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ankesën e kreditorit ta hedhë poshtë si të pa bazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KUR "Mitrovica" J.S.C, Sh.A, me datë 05.04.2023 ka paraqitur propozimin për përmbaremore ndaj debitorit A. Q., – Ordinanca Stomatologjike, me seli në V., mbi bazën e kartelës financiare të konsumatorit me shifër V2493 për periudhën 01.08.2020 deri më 04.04.2023, me propozim që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, kreditorit t'ia paguaj shumën prej 339.47 Euro me kamatë ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së propozimit, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Përmbareuesi Privat Fazli Gjonbalaj me seli në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit me urdhrin përmbaremore P.nr. 106/23, të datës 05.04.202, e ka lejuar përmbaremin e propozuar nga kreditori.

Debitori kundër këtij urdhri ka ushtruar prapësim, duke theksuar se borxhi është caktuar në mënyrë paushalle, mirëpo edhe po të ekzistonte ky borxh, i njëjti është parashkruar, bazuar në nenin 360 par. 1, pika 1.1 të LMD-së. Ka shtuar se e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar për çdo muaj parashkruhet në afat prej 1 viti. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhrin përmbaremore ta anuloj.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka theksuar se propozimin për përmbaremore e ka paraqitur në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstrakteve të verifikuar nga librat afarist, ashtu siç parashihet me nenin 29 par. 1.2 dhe nenit 40 par. 1 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se sa i përket pretendimeve të debitorit për parashkrim sipas nenit 360 të LMD-së, nuk mund të llogaritet afati i parashkrimit sipas këtij neni sepse pasi që kemi të bëjmë me person juridik vlen neni 355 i LMD-së, ku për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale parashkrimi fillon të rrjedhë pas

3 viteve, si dhe kemi të bëjmë edhe më ndërprerje të parashkrimit për arsye se debitori i ka pranuar shërbimet e nga kreditori dhe i njëjti është faturuar për shërbimet e ujit sipas ujëmatësit. Ka shtuar se debitori ka pranuar faturat dhe ka bërë pagesë të obligimeve kohë pas kohe, ashtu që ka bashkangjitur ekstraktet e faturave nga librat e kontabilitetit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerçiale e Kosovës–Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1505/23, të datës 01.08.2024, në dispozitiv ka vendosur ta pranoj si të bazuar prapësimin e debitorit A. Q., – Ordinanca Stomatologjike, me seli në V., i paraqitur kundër urdhrit përmbarrimor P.nr.106/23, i lejuar me datë 05.04.2023 nga Përmbarruesi Privat Fazli Gjonbalaj, dhe të njëjtin urdhër e ka shfuqizuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1, ngase në propozim për përmbarrim kreditori nuk ka paraqitur të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht në propozim për përmbarrim është ushtruar ndaj A. Q., – Ordinanca Stomatologjike, duke mos treguar saktë debitorin, numrin personal apo numrin e biznesit të tij, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme për identifikimin e debitorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerçiale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerçiale e Kosovës- Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarrimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se neni 38 në par.1 dhe par.2 të LPP-së përcakton se : 1. *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”*.

Ndërsa par.2 përcakton se : *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.*

Në anën tjetër neni 43 të LPP-së përcakton se *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin të përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.*

Sipas dispozitave të lartcekura rezulton që urdhri mbi lejimin e përmbarimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38 par.1 të LPP-së, ngase në propozimin për përmbarim kreditori nuk ka treguar të dhënat e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht propozimi për përmbarim është ushtruar ndaj A. Q., – Ordinanca Stomatologjike por pa asnjë të dhënë lidhur me numrin e biznesit apo numrin personal identifikues, pasi nuk dihet se propozimi për përmbarim a drejtohet për subjektin Ordinanca Stomatologjike apo për palën A. Q., apo kemi të bëjmë me debitor solidarë, prandaj këto të dhëna nuk janë të mjaftueshme për identifikimin e debitorit. Si rrjedhojë, në rastin konkret sipas shkresave të lëndës konstatohet se Kartela financiare e konsumatorit me shifër V2493, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara nga neni 38 dhe 43 të LPP-së, pasi që numri personal identifikues apo numri i regjistrimit të biznesit të debitorit nuk është evidentuar në fazën para lejimit të përmbarimit, qoftë duke evidentuar numrin e saktë personal të debitorit apo të dhëna të sakta që mund të identifikohet debitori, prandaj si i tillë urdhri përmbarimor duhet të refuzohet pasi i njëjti nuk ka mbështetje ligjore.

Nga të lartcekurat, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e ankimuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Në procedurën e ankesave nuk mund të pranohen

tani pretendimet për plotësimin e lëndës, sepse kreditori ka pasur obligim ti përmbahet dispozitave ligjore, që me rastin e ushtrimit të propozimit për permbarim të paraqes shenimet e sakta identifikuese të debiorit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1831/24 datë 27.12.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha